Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin 4-mujorin e II- rë të vitit 2025.

• **Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:**

Në 000 lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	4,427	2,825	64%
Sigurimet Shoqërore	601	756	471	62%
Mallra dhe shërbime	602	7,725	3,014	39%
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606	72	0	0%

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Kapitale të Trupëzuara	231	10,574	0	0

Totali

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
23,554	6,310	27%

QËLLIMI 1 i Politikës së Programit

- Rritja e aksesit dhe cilësisë së strukturave sportive dhe rekreacionale për të nxitur një jetë aktive dhe të shëndetshme për të gjithë qytetarët, duke përfshirë mbështetjen e sporteve dhe aktiviteteve rekreacionale që përforcojnë bashkësinë dhe ofrojnë mundësi për përfshirje sociale.

Objektivi 1.1 i Politikës së Programit

- Bashkia mbështet organizimin e eventeve sportive dhe argëtuese. Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës për sport dhe arëtim. Promovimi dhe mbështetja e ekipeve dhe sportistëve vendore.

Produktet

Emri	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt	Shpz në ,000 lekë	
				Shpz Plan i rishikuar	Shpz Fakt
Shërbimi i stafit të Sportit dhe Argëtimit	Numër	6	6	5,255	3,296
Disiplinat e ndryshme sportive të mbështetura	Numër	3	0	145	0
Mbështetje për klubin e futbollit	Numër	1	1	7,580	3,014

Të Dhëna mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

- Përfitite në natyrë të struktura dhe terrene për veprimtari sportive,
- Hapësira publike çlodhëse dhe argëtuese ;

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Siperfaqe	Siperfaqia e ambjenteve sportive dhe argetuese ne m2	450	450

Mirembajtja e terreneve sportive.

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
------------	---------------	------	------

Mirembajtja e tereneve për veprimtari sportive	Numri i tereneve sportive të mirëmbajtura	4	4
--	---	---	---

Të dhëna

Emri	Njesia masese	Plan i rishikuar	Fakt
Ekipi i futbollit meshkuj të rritur	numër	22	24
Ekipi i futbollit meshkuj të vegjël	numër	71	71
Ekipi i Boksit meshkuj të rritur	numër	13	10
Ekipi i Boksit meshkuj të vegjël	numër	15	19
Ekipi i volejbollit femra të vegjël	numër	14	12
Trajner ekipi të rritur Futboll	numër	2	2
Trajner ekipi të vegjël Futboll	numër	2	3
Trajner ekipi të vegjël Boks	numër	1	1
Trajner ekipi të vegjël Volejboll	numër	1	1
Ndeshje futbollit për të rritur	numër	15	20
Ndeshje futbollit për të vegjël	numër	40	40
Ndeshje Volejbollit për vajza	numër	3	3

Projektet e Investimeve të Programit

Në 000 lekë

Kodi i projektit	Emri i projektit	Vlera e plotë e projektit	Fillon	Mbaron	Plan i rishikuar	Fakt
1120116	Ndërtim i fushave të basketbollit	10,574	2025	2025	10,574	0

Investimet parashikohen në njësinë shpenzuese në Bashkinë Patos si njësi planifikimi.

III.6 Programi Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe M. e konsumatoreve. ASHP.

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit

04220

Emri i Programit

Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve

Përshkrimi i Programit

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për

çështjet dhe shërbimet bujqësore; Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liqensave të gjuetisë; Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural. Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës;

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike (buxheti plan dhe buxheti faktik) dhe realizimin për 4-mujorin e I-rë të vitit 2025.

• Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike ,000leke

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	Plan	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	3,203	1,376	43%
Sigurimet Shoqërore	601	546	182	33%
Mallra dhe shërbime	602	7,047	1,615	23%
Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët	606	61	0	0 %

Totali

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
10,857	3,173	29%

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

QËLLIMI 1 i Politikës së Programit

- Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj, krijimi projekteve ne mbështetje të fermerëve si dhe fuqizimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera.

Objektivi 1.1 i Politikës së Programit

- Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për mbrojtjen dhe administrimin e resurseve natyrore dhe bujqësore, fuqizimi i fermerëve dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore dhe kategorive të tjera në funksion të bujqësisë.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Produktet

Shpz në ,000 lekë

Emri	Njesia matese	Plan	Fakt	Shpz plan	Shpz Fakt
Fermerë të mbështetur për zhvillimin bujqësor	numër	4135	400	9,857	2,227
Grante për fermerët	numër	15	0	1,000	72

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera.

1. Bashkia mbështet rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet forcimit të inspektimit dhe sigurisë ushqimore

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Rregullimi i tregjeve nga bashkia	Raporti në % i tregjeve të aprovuara nga bashkia kundrejt tregjeve të planifikuara në PPV	66.67	66.67

1 Bashkia mbështet rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Emri	Njesia matese	Plan	Fakt
Numri i rasteve të gjetura/inspektuar të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale në vende dhe tregje informale	numër	0	0
Numri i tregjeve funksionale të aprovuara (bujqësor, industrial etj)	numër	3	2

Të Dhëna mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Emri	Njesia matëse	Plani	Fakt
------	---------------	-------	------

Numri i stafit	numër	3	2
Numri i tregjeve (bujqësor, industrial, etj.) të planifikuara në planin e përgjithshëm vendor	numër	3	2

Mbi realizimin e programit:

Në zbatim të funksioneve që ka secili dhe planifikimit të detyrave për 4-mujorin e II të vitit 2025, jemi përkushtuar për realizimin e tyre.

1. Dhënia asistenc fermerëve për aplikimet në skemën e naftës, 146 raste. Asistence e banorëve për plotësimin e kontratave të qerasë si edhe konfirmimet e tyre, 47 raste. Këkesa bashkëpunimi institucioneve të ndryshme, 13 raste. Verifikime kerkesash dhe ankesash, 30 raste. Inspektimi i punimeve me skrep dhe ekskavator në pastrimin e kanaleve dhe sistemimin e rrugëve, marrja në dorëzim e punimeve, pregatitja e situacioneve. Kontakti me fermerët në fermat blegtorale.
6. Komunikim me fermerët për të dhënat e rendimentit të kulturave dhe hedhja e tyre në regjistrin e fermerit, 115 komunikime.

III.7 Programi Programet Menaxhimi i mbetjeve, Mbrojtja e Mjedisit, Bashkia

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
05100	Programet e mbrojtjes së mjedisit	Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes; Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes; Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin e 4-mujorit të II- rë të vitit 2025.

Shpenzimet e Programit sipas kategorive ekonomike

,000

lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	774	774	100%
Sigurimet Shoqërore	601	131	123	94%
Mallra dhe shërbime	602	463	18	4%
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606	10	0	

Totali

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
1,378	915	66%

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

- Qëllimi 1. Mbrojtja e mjedisit duke rritur cilësinë e jetës së komunitetit dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve.
- Objektivi 1.1 Mbrojtja e mjedisit për një ambient të pastër.
- Objektivi 1.2 Ndërgjegjësimin mjedisor për të gjithë popullsinë duke e bërë një model jetesën në harmoni me mjedisin.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Produktet

Emri	Njesia matese	Plan	Fakt	Shpz në ,000 lekë	
				Shpz plan	Shpz Fakt
Subjekte të inspektuara	numër	30	6	1,285	564
Promovimi i mbrojtjes së mjedisit	numër	28	10	93	0

1 Mbrojtja e mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve.

1. Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për mbrojtjen mjedisore

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Rritja e numrit të kontrolleve dhe inspektimeve në terren për mbrojtjen e mjedisit	Kontrolle dhe Inspektime në terren, ndryshimi vjetor në numër	30	14
Rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit në komunitet	Takime të organizuara në komunitet për mbrojtjen e mjedisit, ndryshimi vjetor në numër	28	15

1.2 Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për mbrojtjen mjedisore

Emri	Njesia matese	Plan	Fakt
Shërbime dhe monitorime të mjedisit (DDD dhe monitorim i parametra mjedisorë).	numër	2	1
Ankesa për ndotjen nga zhurmat, nga mbetjet (urbane, bujqësore, blegtorale) dhe ndotjen nga hidrokarburet.	numër	15	3
Projekt-vendime ose projekt-urdhëresa për administrimin e mjedisit	numër	1	1
Numri i subjekteve të pajisur me leje për depozitimin e mbetjeve	numër	2	3

Të Dhëna mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Emri	Njesia matese	Plan i rishikuar	Fakt
Numri i stafit	numër	1	1

Mbi realizimin e programit

Në zbatim të funksioneve që ka secili dhe planifikimit të detyrave për 4-mujorin e dytë të vitit 2025, jemi përkushtuar për realizimin e tyre.

Emërtimi	(Nr) 4- mujori i II	Nr 8- mujori
Shkresa të brendshme (Kërkesa për prokurim, urdhër për mbjellje të reja, etj)	18	25
Korrespondencë me institucione të ndryshme.	56	114
Njoftim për marrje masash drejtuar qytetarëve.	0	2
Kthim përgjigje qytetarëve.	2	15
Zbatimi i urdhërave të ndryshme (apelimi tatimor, arkiva, subjektet funerale, funksionet e sp. të bujqësisë)		4
Pjesëmarrje në dëgjuesat për pajisjen e subjekteve me leje mjedisi	1	3
Aktivitete	5	15
Sqarime qytetarësh dhe asistencë për aplikim në skemën kombëtare të bujqësisë.	93	167
Shkresa për sektorin e MZSH-së.	108	157
Hartimi i planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve	1	1
Vërtetime toke (11 që kanë tokë dhe 13 që s'kanë tokë)	13	37
Trajnime të ndryshme	4	7
Të tjera (Detyra për rregulloren, programe pune për aktivitetet, Planveprimi mjedisor 2025, Kthim përgjigje kërkesave të KLSH, Planvendosje për rrugët bujqësore, Hedhja në excel i formularëve nr. 6, Takime me AKMC për Planin e Emergjencave, Konsultim publik për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve, Monitorimi i parametrave mjedisorë në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, kryerja e shërbimit DDD në institucionet arsimore, Hartim VNM-je për rrugët “Kripallarët”, Hartim VSM-je për Planin e Mbetjeve, etj.)		

III.8 Programi Rrugë Rurale (Infrastruktura) Bashkia

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
04520	Projekte Zhvillimi	Ndërtim, mirëmbajtje, zgjerim, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatëse me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore. Hartimi dhe monitorimi i projektve që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin për 4-mujorin e II-të të vitit 2025.

Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	17,800	11,133	29%
Sigurimet Shoqërore	601	3,221	1,661	26%
Mallra dhe shërbime	602	5,362	1,578	0%
Të tjera transferta korrente të brendshme	604	0	0	0
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606	90	0	0
Kapitale të Grupëzuara	230	6,557	102	2%
Kapitale të Trupëzuara	231	203,119	36,360	3%

Totali:

Plan 2025	Fakt	Realizimi
236,149	50,834	22%

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Qëllimi

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe urbane për të siguruar akses të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas për të gjithë përdoruesit, duke përfshirë zhvillimin e rrugëve, urave dhe strukturave të tjera të transportit.

Objektivat e Politikës së Programit

1.1 Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës . Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit. Planifikimi urban i qëndrueshëm.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Shpz në ,000 lekë

Nr	Emertimi	Njësia	Plani	Fakti	Shpz Plani	Shpz Fakti
1	Investime, përmirësimi i infrastrukturës me standardet më të mira bashkëkohore	numër	16	3	209,676	36,462
2	Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural	numër	17	17	21,111	12,794
3	Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur	km	7	0	3,000	0
4	Shpronësime në funksion të projekteve të investimeve	numër	2	1	2,362	1,578

Projektet e Investimeve të Programit:

Tabela nr. 6

Në mijë lekë

Kodi Projekti	Kodi programi	Emertimi i projektit	Buxheti 2025	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujori/ II)	Komente
1120160	04520	Rikonstruksion i bllokut përpara pallatit të Kulturës	40,054	16,256	Në proces zbatimi
1120161	04520	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të bllokut të vreshtit, Lagjja e re.	44,343		Në proces zbatimit
1120183	04520	Rehabilitim i sheshit Lagjja e re	3,000		Në proces
1120182	04520	Restaurim i fasadave në lagjen naftëtari	1,000		
	04520	Rikonstruksion i blloqeve të banimit në lagjen 1 Maj	16,904		Përfunduar projekti . Do

Kodi Projekti	Kodi programi	Emertimi i projektit	Buxheti 2025	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujori/ II)	Komente
1120180					procedohet per prokurim.
1120023	04520	Rikonstruks. Rruges L.Re te Perroi Cam + Mbikqyres + Kolaudues	7,734		Në proces
1120158	04520	Ndertim mure mbajtese ne qytet dhe rrethina + Mbikqyres + Kolaudues	2,154	2,064	Përfunduar
1120159	04520	Blerje Baze Materiale per Rikonstruksionin e Rrethimit te varrezave Publike dhe zgjerimin e rrugeve te Brendshme	5,000	4,180	Në proces zbatimi
1120136	04520	Rikonstruksion i rruges Industriale , kryqezimi ku bashkohet me rrugen Franc Nopce + Mbikqyres+ Kolaudues	8,868	8,538	Në proces
1120137	04520	Rruga " Unazë.- Varreza- pikë takimi Rr,Dh.Tanaka + Mbikqyres + Kolaudues	13,335		Në proces
1120110	04520	Sistemimi i Hapsires Publike dhe parkim pas bllokut te ish bashkise + Mbikqyres+ Kolaudues	1,344		Në proces
1120155	04520	Rehabilitim dhe rikonceptim të lulishtes prane stadiumit + Kolaudues	2,660	2,660	Përfunduar
1120145	04520	Mbikqyres Rehabilitim i Pjesshëm i Godinës së Njësisë Administrative Ruzhdie	59		Në process likuidimi
1120178	04520	Mbikqyrje+Kolaudim per ndertim muri mbajtes me struktura metalike per perforcim bazamenti dhe rik rruges se demtuar nga rreshqitja e dherave	465	346	Në process likuidimi
1120075	04520	Blerje baze materiale sinjalistika rrugore	1,485	1,485	Përfunduar
1120114	04520	Hartimi i PDV--VE te percaktuara sipas PPV-SE dhe studim projektim per projekte	6,317	102	Në proces
	04520	Rikonstruksion rruga "Ali Laze dhe Qerim Gropa"	20,000	57	Përf oponenca, Në

Kodi Projekti	Kodi programi	Emertimi i projektit	Buxheti 2025	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujori/ II)	Komente
1120187		(mbikqyrës+kolaudues+oponencë teknike)			proces prokurimi.
1120188	04520	Rikonstrukcion rruga "Kripallarët" (mbikqyrës+kolaudues+oponencë teknike)	29,666		Në proces
1120189	04520	Rikonstrukcion i rrugës Frashër-Fshat i Ri Zharrëz (Mbikqyrës + Kolaudues)	205		Përfunduar
		SHUMA 04520	209,676	36,462	-

Mbi realizimin e programit

Monitorimi i objekteve që nga faza e preventivimit, zbatimit, kontrollit gjatë zbatimit deri në aktin e marrjes në dorëzim ka qënë një prej prioriteteve të shërbimeve.

Për monitorim me efektiv nga ana jonë objektet i kemi ndarë në tre kategori:

- a) Ndërtime me Agjencinë e Shërbimeve Publike
- b) Objektet e investimeve
- c) Të ndryshme

Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit gjatë periudhës Janar-Gusht 2025 janë ndjekur, monitoruar dhe realizuar këto objektiva:

1. Njohja me investimet e parashikuara në objekte dhe infrastrukturë për vitin 2025.
2. Hartimi i projekteve, preventivave të këtyre objekteve dhe rakordimi me drejtoritë përkatëse, me Agjencinë e shërbimeve Publike, në varësi të natyrës së ndërhyrjes.
3. Ndjekja e ecures së punimeve të ndërhyrjes në objektet e investimeve.
4. Verifikim ankesave të qytetarëve dhe kthim përgjigje shkresave të ndryshme.

Spektori i Shërbimeve:

Ndjekja e punimeve që kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike si më poshtë:

- a) Ndjekje e punimeve për sinjalistikën rrugore.
- b) Ndjekje e punimeve për shtrimin e rrugëve me çakëll për parcelat bujqësore.
- c) Ndjekje e punimeve mbi shtrimin i rrugëve të marrëveshjes Kuadër për vitin 2025-2026.
- d) Ndjekje e punimeve për ndërtimin e shesheve në lagjet e qytetit.
- e) Ndjekje e riparimeve të linjave elektrike ekzistuese dhe linjat e reja.
- f) Hartimi i preventivit për blerje bazë materiale për riparimin e KUZ në disa zona

në qytet dhe njësitë administrative.

- g) Monitorim i kontratave të lidhura gjatë vitit 2024 dhe vitit 2025 dhe vazhdojnë zbatimin në 2025.
- h) Vlerësimi i kërkesave për licencimin e mjeteve për transportin e njerëzve dhe mallrave.
- i) Vlerësimi i kërkesave për licencim karburantesh për tregtim me shumicë dhe pakicë.

Sektori i Projekteve:

1. Hartimi i projekteve të ndryshme.
2. Hartim i raportimeve të ndërmjetme për çdo ndryshim të secilit objekt.
3. Verifikimi i dokumentacioneve të objekteve të zbatimit.

A. NE FUSHEN E INVESTIMEVE

- **Ndërtim mure mbajtës në qytete dhe rrethina.**

Për shkak të relievit kodrinor të qytetit të Patosit, problematika e rrëshqitjes së dherave mbetet prezente dhe për eliminimin apo parandalimin e rrëshqitjeve të mundshme janë të nevojshme ndërhyrjet për stabilizimin e tyre nëpërmjet ndërtimit të mureve mbajtëse. Ka përfunduar ndërtimi i katër mureve mbajtëse në zonat si më poshtë:

Zona 1: Dukas Breg, degëzimi i rrugës “Late Bregu”, pranë Kishës Ortodokse

Zona 2, Rruga “Dhori Tanaka”, Dukas

Zona 3, Rruga “Banaj”

Zona 4, Rruga “Rrapi Tikur”, Dukas

- **Rehabilitim i sheshit, Lagjja e “Re”**

Në kuadër të përmisimit të infrastrukturës së qytetit do të rehabilitohet sheshi tek lagjja e “Re” me qëllim përmisimin e shërbimeve për komunitetin. Ai ndodhet në një prej pikave kryesore të qytetit dhe me fluksin më të lartë të lëvizjes së banorëve.

Si pasojë e mungesës së ndërhyrjeve në mirmbajtjen dhe sistemimin e tij gjendja e sheshit është problematike dhe në kushte të papërshtatshme për t’u shfrytëzuar nga banorët.

Në objekt janë evidentuar disa problematika si pasojë e mungesës së paketës së shtresave, sistemimit të ujërave të bardha, pranisë së mbetjeve të ndryshme, duke u kthyer dhe shqetësim për banorët që jetojnë në këtë lagje.

Janë parashikuar ndërhyrje për rehabilitimin me të gjithë elementët e nevojshëm në një sipërfaqe prej 200 m². Fillimisht do të realizohet skarifkimi i shtresave egzistuese, pastrim i zonës dhe me pas realizimi i paketës së shtresave të përcaktuara në projekt. Do të realizohet sistemimi i ujërave të bardha nëpërmjet pusëve shimbledhëse dhe rregullimit të pjerrësisë së hyrjeve të pallateve sipas terrenit dhe kuotave në lidhje me trotualet dhe sheshet në ato zona ku është parashikuar si e domosdoshme. Është në proces prokurimi.

- **Restaurim i fasadave në lagjen “Naftëtari”**

Ky investim konsiston në restaurimin e fasadave të pallateve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve që jetojnë në këto objekte kryesisht 3 katëshe. Objekti ka një fasadë tejet të amortizuar dhe ka një sipërfaqe prej 430 m².

Projekti përfshin suvatimin dhe lysterjen e fasadave dhe ka një rendësi të veçantë, pasi bëhet fjalë për disa nga objektet përgjatë rrugëve kryesore të qytetit. Me anë të këtij projekti do të përmirësohen kushtet e objekteve ekzistuese të ndërtuara kryesisht rreth viteve '90 dhe më parë të cilat shfaqin probleme si me lagështinë, mungesën e suvatimeve apo në disa raste rrezikohet rënia e tyre duke u kthyer në një problematik për banorët. Do të realizohet në muajt në vijim.

- **Rikonstruksion i blloqeve të banimit në lagjen “1 Maj”**

Objekti ndodhet në lagjen “1 Maj”, Patos dhe kufizohet nga segmentet e rrugëve kryesore “Unaza”, “7 Marsi” dhe “Koli Marku”. Blloku ka një sipërfaqe prej rreth 68,450m² dhe sipërfaqja në të cilën do të ndërhyhet është ndarë në 4 zona secila me një sipërfaqe prej:

$Sip_{(zona A)}=21,338 \text{ m}^2$; $Sip_{(zona B)}=13,314 \text{ m}^2$; $Sip_{(zona C)}=19,320 \text{ m}^2$;
 $Sip_{(zona D)}=8,931 \text{ m}^2$;

Infrastruktura rrugore, kryesisht rrugët e brendshme, kalimet e këmbësorëve mungojnë totalisht në zonë, duke përbërë një rrezik për banorët e lagjes. Aksesueshmëria brenda për brenda bllokut është e vështirë sidomos përgjatë ditëve me reshje të denduara ku mungesa e kanalizimeve përbën një pengesë të madhe për kalimin e mjeteve dhe lëvizjen e banorëve.

Punimet që përfshin ky projekt:

1. Rehabilitimin e zonës me të gjithë elementët e nevojshëm infrastrukturor.
2. Parashikimin e kalimeve për këmbësorët me të gjitha shtresat përkatëse dhe të konturuara me bodura të parafabrikuara.
3. Në pjesët e ndërprerjes së trotuarëve do të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftësi të kufizuar.
4. Përcaktimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale.
5. Do të realizohet ndriçimi i zonës sipas parametrave dhe standarde në fuqi.
6. Sistemimi i ujrave të bardha dhe të zeza.

Projekti ka përfunduar dhe do të procedohet me etapat e tjera.

- **Rikonstruksion i rrugës “Ali Laze” dhe “Qerim Gropa”**

Rrugët të cila do të nënshtrohen rikonstruksionit ndodhen në “Lagjen e Re”, në pjesën jug-perëndimore të qytetit të Patosit. Rrugët kanë gjatësi përkatësisht:

-Rruga “Ali Laze”, L=680.21 (duke përfshirë dhe degëzimet)

-Rruga “Qerim Gropa”, L=360m

Në këto segmente janë bërë ndërhyrje të pjesshme përgjatë kohës, kryesisht në kanalizime të ujrave të bardha dhe ndricim rrugor. Problematik kryesore e këtyre segmenteve mbetet paketa e shtresave rrugore, e cila është pjesërisht e amortizuar dhe pjesërisht mungon duke u kthyer në një problematik për banorët dhe automjetet që qarkullojnë në këtë zonë.

Projekti parashikon ndërhyrje në të gjithë gjatësinë e rrugës “Ali Laze” dhe degëzimet e saj. Bazuar në karakteristikat e ndërhyrjeve në trupin e rrugës dhe tipin e profilin terthor, segmentet rrugore do të trajtohen, si me poshtë:

Aksi kryesor i rrugës: Elementët përbërës kryesor të këtij segmenti janë karrexhata, e cila ka një gjërësi asfalti prej 4 m ose 400 cm dhe do të jetë me pjerrësi të njëanshme në krahun e djathtë, kah në të cilin ndodhet edhe një kanal ekzistues betoni për grumbullimin dhe kanalizimin e ujrave të bardha.

Degëzimet: Akset e tjera janë trajtuar me gjerësi karrexhate në varësi të hapësirës së lejuar urbane dhe fluksit të mjeteve në zonë. Në baze të këtij vlerësimi, akset (degëzimet) do të kenë gjerësi karrexhate 2.5-3m, me pjerrësi të varësi të kushteve të terrenit.

Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:

- *Shtrese Cakelli 15 cm*
- *Stabilizant 10 cm*
- *Binder 5 cm*
- *Asfaltobeton 3 cm.*

Në rrugën “Qerim Gropa” do të ndërhyhet me rikonstruksionin e shtresës së dëmtuar të asfaltobetonit përgjatë gjithë gjatësisë. Është në proçs prokurimi.

- **Rikonstruksion i rrugës “Kripallar”**

Rruga e cila do ti nënshtrohet rikonstruksionit ndodhet në zonën Dukas-Kripallar. Hyrja e këtij segment rrugor ndodhet rreth 200 m nga rruga “Unaza. Gjatësia e segmentit kryesor të rrugës është 1260 m, me disa degëzime të ndërmjetme me gjatësi 1017 m, në total rruga që do ti nënshtrohet rikonstruksionit ka gjatësinë prej 2277m, ose 2.277 km.

Aksi kryesor i rrugës ka patur ndërhyrje të pjesshme përgjatë kohës, ku sipërfaqja e rrugës është trajtuar me rërë bituminoze, e cila aktualisht ndodhet në gjendje të amortizuar. Është ndërtuar rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza dhe janë vendosur shtyllat e ndricimit.

Punimet që përfshin ky projekt:

Projektiparashikon ndërhyrje në të gjithë gjatësinë e aksit kryesor të rrugës “Kripallarët” dhe degëzimet e saj. Bazuar në karakteristikat e ndërhyrjeve në trupin e rrugës dhe tipin e profilit terthor, segmentet rrugore do të trajtohen, si me poshtë:

Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:

- *Shtrese Cakelli 15 cm*
- *Stabilizant 10 cm*
- *Binder 5 cm*
- *Asfaltobeton 3 cm.*

- **Rikonstruksion i bllokut përpara pallatit të kulturës**

Objekti ndodhet në Lagjen “Naftëtari”, në zonën përpara Pallatit të Kulturës. Ky bllok banimi kufizohet në pjesën jugore nga Shëtitorja “Republika”, në pjesën veriore nga rruga “Demokracia”, në lindje nga rruga “Heronjtë e Linasit” dhe në perendim nga rruga “Sulo Goxhaj”. Për shkak të mungesës së ndërhyrjeve, hapësirat rreth pallateve janë të pasistemuara, ka ndodhur zaptim i

hapësirave publike me ndërtime informale, sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza ekziston pjesërisht, por në gjendje të amorizuar dhe pa kapacitetin e mjaftueshëm për të grumbulluar dhe kanalizuar gjithë shkarkimet në zone, rrjeti i ndricimit mungon plotësisht, mungojnë hapësirat e gjelbëruara dhe sistemuara për banorët, lulishte apo kënde lojrash për fëmijë, hapësirat për parkim si dhe rrjeti i rrugëve të brendshme ka nevojë për rikonstrukcion pasi është i amortizuar dhe krijon vështirësi në qarkullimin e banorëve dhe mjeteve.

Për ndërhyrje të strukturuar projekti do të trajtojë 4 zona/ minibloqe kryesore dhe rrugët “Thimi Sinjari” dhe “Ahmet Bajo”.

$Sip_{(Zona\ 1)} = 1435\ m^2$; $Sip_{(Zona\ 2)} = 2385\ m^2$; $Sip_{(Zona\ 3)} = 2055\ m^2$; $Sip_{(Zona\ 4)} = 878\ m^2$;. Është në proces.

- **Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme të bllokut të Vreshtit**

Rruga e cila do ti nënshtrohet rikonstrukcionit ndodhet në “Lagjen e Re”, në pjesën jug-perendimore të qytetit të Patosit dhe përfshin degezime të rrugëve në vazhdim të rrugës së Vreshtit. Gjatësia totale e rrugës shkon 2,350 m. Gjatësitë përkatëse të degëzimeve që përfshihen në këtë rrugë janë përkatësisht:

- 1.Rruga “Vreshti” 53 m
- 2.Rruga “Tomorri” 163 m
- 3.Rruga “Qerim Gropa” 228 m
- 4.Rruga “Riza Cerova” 390 m
- 5.Rruga “Liri Gero” 228 m
- 6.Rruga “Arben Boci” 700 m
- 7.Rruga “Lefter Talo” 588 m

Gjendja aktuale e kësaj rruge është në kushte jo të mira, kemi mungesë të kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, mungesëtë trotuareve dhe ndricimit rrugor.

Segmentet rrugore do të pajisen me paketën e shtresave:

Shtresë Cakëlli $t=15\ cm$

Stabilizant $t=10\ cm$,

Binder $t=5\ cm$

Asfaltobeton $t=3\ cm$.

- **Rehabilitim dhe rikonceptim i lulishtes para stadiumit . Rehabilituar.**

Objekti në fjalë ndodhet në Lagjen “Naftëtari”, përgjatë rrugës “Unaza”, në pjesën veriore të shkollës “Muhamet Shehu”. Hapësira ka një sipërfaqe rreth 3950 m² ku pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë dy fushat sportive. Aktualisht, kjo hapësirë shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve sportive nga individë apo grupe të ndryshme të qytetit.

Si një ambient me hapësirë të konsiderueshme dhe me një pozicion të rëndësishëm përgjatë rrugës, nisur edhe nga reagimet e qytetarëve të ndryshëm, kjo hapësirë ka element të vakët dhe mungesë infrastrukture për t’u shfrytëzuar nga gjithë grupmoshat në qytet dhe për këtë arsye ka nevojë për ndërhyrje në rikonceptim dhe rijetëzimin e kësaj hapësire, duke rikonstruktuar elementet bazike të fushave ekzistuese si dhe duke krijuar minihapësira të reja me lojra për fëmijë, hapësira të gjelbëruara, implementim të pajisjeve sportive të palëvizshme, pista vrapimi etj.

Punimet për rehabilitimin e lulishtes kanë përfunduar duke i shtuar bashkisë Patos një ambient bashkëkohor për argëtimin dhe clodhjen.

- **Blerje bazë materiale për Rikonstruksionin e Rrethimit të varrezave Publike dhe zgjerimin e rrugëve të Brëndshme**

Me qëllim mirëmbajtjen e varrezave të qytetit dhe të njësive administrative të bashkisë Patos janë parashikuar të gjithë materialet e domosdoshme që nevojiten për riparimin dhe zëvendësimin e elementëve përkatës. Këto materiale do të shpërndahen sipas një grafiku dhe preventivave të përcaktuar nga bashkia Patos. Në preventiva është përcaktuar gjithë baza materiale më vete që do të shpërndahet pranë objekteve të varrezave. Ato do përdoren për objektet si mëposhtë:

- Varrezat në Njësine Administrative Zharrëz
- Varrezat në fshatin Margëlliç
- Varrezat në Frashër, Nj. A Zharrëz
- Varrezat në fshatin Ruzhdië
- Varrezat në fshatin Kuqar
- Varrezat në fshatin Rërës
- Varrezat në fshatin Banaj
- Varrezat tek Lagjja e Re
- Varrezat në Verbas
- Varrezat e Qytetit, parcelat N1, N2, N3

- **Rikonstruksion i rrugës ‘Lagjja e Re’, te Përroi Cam**

Rruga e cila i është nenshtrohet rikonstruksionit ndodhet në “Lagjien e Re”, në pjesën jug-perendimore të qytetit të Patosit dhe përfshin segmentin e rrugës kryesore me gjatësi rreth 880 m dhe një sërë degezime/ segmente dytesore me gjatësi rreth 476 m. Në total gjatësia e rrugës që është rehabilituar është 1356 m. Projekti ka parashikuar ndërhyrjen në të gjithë gjatësinë e këtij segmenti, të përbërë nga aksi kryesor dhe degëzime dytesore të saj duke përfshirë dhe kanalizimet e ujërave të bardha të zeza, po ashtu dhe hapësira të gjelbra. Projekti përfshin gjithashtu ndricimin e rrugës përgjatë gjithë gjatësisë së saj duke përfshirë dhe degezimet dytesore. Janë parashikuar vendosje shtylla ndricimi me lartësi 7 m, me ndricim Led 50W + Panel FV+ bateri, në distancë rreth 30 m larg nga njëra tjetra. Në proces.

B. MBI NDËRMARRJEN VARTËSE

- Ndjekja e problemeve me Ndërmarrjen e Ujësjellësit për korrigjimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.
- Ndjekja e problemeve të shtimit të sipërfaqeve të gjelbëruara dhe mirëmbajtjes së tyre.
- Ndjekjen e procesit të paisjes me sinjalistikë rrugore në qytet dhe Njësitë Administrative.

C. NE FUSHËN E EMERGJENCAVE CIVILE

- Monitorimi i rezervuarit Zharrëz, nxjerrja e detyrave për mirëmbajtjen e tyre.
- Informacione në Komitetin Kombëtar të Digave të mëdha për problemet e qëndrueshmërisë së digave dhe aksesoreve të tyre.

- Vazhdon hartimi i plan-veprimit në raste të emergjencave civile (zjarre, përmytje, termite, epidemikë etj në vazhdim).
 - a) pikat e rrezikut.
 - b) masat afatmesme.
 - c) masat afatgjata.
- Hartimi i planit të masave vetëm për rastet e mundshme të zjarreve.

D. NË FUSHËN E URBANISTIKËS

1. Në sistemin e leje gjatë periudhës janar-prill 2025 janë shqyrtur gjithsej:

a. Deklaratë paraprake	6
b. Leje zhvillimi	4
c. Leje infrastrukture	5
d. Leje ndërtimi	1
e. Çertifikatë përdorimi	2
2. Janë shqyrtuar gjithsej 60 kërkesa për njoftim dhe vetdeklarim kryerje punimesh.
3. Janë hartuar gjithsej 39 planvendosje, 27 për njoftim fillim punimesh.
4. Çertifikimi i pronave publike gjithsej 2.

E. ANKESAT DHE KERKESAT E QYTETARËVE

Janë marrë nga qytetaret rreth 78 kërkesa dhe ankesa për probleme të ndryshme prej të cilave janë verifikuar, zgjidhur apo kthyer përgjigje negative (sipas legjislacionit në fuqi).

1. -të zgjidhura 32,
2. -në proces 2,
3. -përgjigje negative 4

III.9 Programi Strehimi Social

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
10661	Strehimi Social	Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social nëpërmjet: - Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; - Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; - Rikonstruksion i banesave të familjeve në nevojë.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin 4-mujorin e II-rë të vitit 2025.

Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:

,000 lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	0	0	0%
Sigurimet Shoqërore	601			
Mallra dhe shërbime	602	6,434	4,867	86 %
Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët	606	0	0	0%
Kapitale të Trupëzuara	231	800	0	0%

Totali

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
6,434	4,867	76%

Qëllimi 1 i Politikës së Programit

- Rikonstrukcioni i banesave me kushte të papërshtatshme për grupet e pafavorizuara dhe trajtim me bonus qeraje

Objektivi 1.1 i Politikës së Programit

- Përmirësimi i jetës së familjeve në nevojë dhe grupet e pafavorizuara.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Shpz në ,000 lekë

Produktet	Njësia matëse	Plan	Fakt	Shpz Plan	Shpz Fakt
Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë	Numër	40	2	600	33
Rikonstrukcioni i banesave të familjeve në nevojë	Numër	15	3	5,834	4,834

Të Dhëna mbi Programin

- Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;

Indikatori	Njesia masese	Plan	Fakt
Mbështetje me bonus qiraje për familjet në nevojë	Numri i familjeve të mbështetura me bonus qiraje	40	2

Gjatë vitit 2025 nga Programi strehimit janë miratuar me V.K.B për bonus qiraje 2 familje

1- Qerem Zyberi

2- Bardhyl Aliaj

- Mirëmbajtje e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Rikonstruktion i banesave të familjeve në nevojë.

Indikatori	Njesia masese	Plan	Fakt
Rikonstruktion i banesave të familjeve në nevojë	Numri i banesave të rikonstruktura	15	3

Gjatë vitit 2025 janë hartuar preventivat e objekteve sipas kërkesave të qytetarëve dhe janë miratuar në mbledhje

III.10 Programi Përkujdesi Social Bashkia

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit
10430

Emri i Programit
Përkujdesi Social

Përshkrimi i Programit

Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet në nevojë, fëmijët në situatë rreziku, viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuar dhe grupe të tjera vulnerabël.

Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore.

Evidentimi, verifikimi dhe rekomandimi i familjeve të varfra, shtresave vulnerabël, grupeve të caktuara sociale, të cilat jetojnë nën një nivel të caktuar jetese për dhënien e ndihmës ekonomike për to si dhe shërbimieve shoqërore, hartimin e projekteve e zbatimin e tyre, bazuar në standartet e përcaktuara.

Përfitimi në para dhe në natyrë për individë që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në varfëri, me fitime të ulëta, fëmijë në nevojë për mbrojtje, viktimat e dhunës në familje etj.);

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin për 4-mujorin e II-rë të vitit 2025.

• **Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:**

Në 000 lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	5,283	3,366	64%
Sigurimet Shoqërore	601	902	562	62%
Mallra dhe shërbime	602	9,123	1,859	20%
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606	10	0	0 %
Kapitale të Trupëzuara	231	36	0	0%

Totali

Plani	Fakt	Realizimi
15,354	5,787	38 %

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Qëllimi 1 . Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale për të siguruar mbështetje të fortë dhe të qëndrueshme për familjet dhe fëmijët, duke u garantuar atyre qasje në burime dhe shërbime që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurinë sociale.

Objektivi 1.1

Të parandalojmë dhe trajtojmë rastet e dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Të mbështesë në trajtim dhe riintegrim viktimat e dhunës në familje. Të sensibilizojmë komunitetin për dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve

Qëllimi 2. Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.

Objektivi 2.1 Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.

Objektivi 2.1 Fëmije që ndjekin çerdhen.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që

do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Shpz në ,000 lekë

Produktet	Njesia masese	Plani	Fakt	Shpz Plani	Shpz Fakt
Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social	numër	6	6	6,195	3,928
Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social	numër	60	55	720	0
Persona që përfitojnë kujdesin social	numër	25	22	4,680	0
Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE	numër	177	150	3,723	1,859
Investime, Kolaudues Kolaudues Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë Bashkefinancim	numër	1	0	36	0

Të dhënat e Programit:

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Evidentimi, verifikimi dhe rekomandimi i familjeve të varfra, shtresave vulnerabël, grupeve të caktuara sociale, të cilat jetojnë nën një nivel të caktuar jetese për dhënien e ndihmës ekonomike për to si dhe shërbimeve shoqërore, hartimin e projekteve e zbatimin e tyre, bazuar në standartet e përcaktuara.

Indikatori	Njesia masese	Plan	Fakt
Identifikimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi për marrjen e shërbimeve.	Numri i viktimave të dhunës në familje të identifikuar.	30	17
Identifikimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimi për marrjen e shërbimeve.	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të identifikuar.	10	15
Identifikimi i familjeve në vështirësi ekonomike dhe referimi për marrjen e shërbimeve.	Numri i familjeve në vështirësi ekonomike të identifikuar.	170	150

Përfitimi në para dhe në natyrë për individ që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në varfëri, me fitime të ulëta, fëmijë në nevojë për mbrojtje, viktimat të dhunës në familje etj.);

Në 000 lekë

Indikatori	Njesia masese	Plan	Fakt
Mbështetja me pagesë për familjet.individët në vështirësi ekonomike	Pagesa për familjet/individët në vështirësi ekonomike	900	514

Trajtimi i rasteve të dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje

Emri	Njesia masese	Plan i rishikuar	Fakt
Raste dhune të trajtuara me shërbim psikologjik	numër	10	0
Raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar	numër	15	6
Familje/individë që kanë përfituar 6% nga të ardhurat e bashkisë	numër	30	21

Emri	Njesia masese	Plani	Fakt
Numri total i rasteve të dhunës të identifikuar	numër	30	17
Numri total i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të identifikuar	numër	10	25
Numri i familjeve/individëve në vështirësi ekonomike të identifikuar	numër	170	150
Raste dhune të trajtuara me shërbim psikologjik	numër	10	0
Raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar	numër	15	6
Familje/individë që kanë përfituar 6% nga të ardhurat e bashkisë	numër	30	21
Individë AK që përfitojnë trajtim	numër	880	880

III.10/1 Programi Përkujdesi Social ASHP.

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit 10430	Emri i Programit Përkujdesi Social	Përshkrimi i Programit Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet në nevojë, fëmijët në situatë rreziku, viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuar dhe grupe të tjera vulnerabël. Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore. Evidentimi, verifikimi dhe rekomandimi i familjeve të varfra, shtresave vulnerabël, grupeve të caktuara sociale, të cilat jetojnë nën një nivel të caktuar jetese për dhënie e ndihmës ekonomike për to si dhe shërbimeve shoqërore, hartimin e projekteve e zbatimin e tyre, bazuar në standartet e përcaktuara.
---	--	---

Përfitimi në para dhe në natyrë për individë që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në varfëri, me fitime të ulëta, fëmijë në nevojë për mbrojtje, viktimat të dhunës në familje etj.)

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin për 4-mujorin e II-rë të vitit 2025.

• **Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:**

Në 000

lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	7,638	5,055	66%
Sigurimet Shoqërore	601	1,275	851	67%
Mallra dhe shërbime	602	900	32	4%
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606	0	0	0%
Kapitale të Trupëzuara	231	100	45	45%

Totali

Plani	Fakt	Realizimi
9,913	5,983	60%

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Qëllimi 1 . Të parandalojmë dhe trajtojmë rastet e dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Të mbështesë në trajtim dhe riintegrim viktimat e dhunës në familje. Të sensibilizojmë komunitetin për dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve.

Objektivi 1.1

Të parandalojmë dhe trajtojmë rastet e dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Të mbështesë në trajtim dhe riintegrim viktimat e dhunës në familje. Të sensibilizojmë komunitetin për dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve

Qëllimi 2. Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.

Objektivi 2.1 Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.

Objektivi 2.1 Fëmije që ndjekin çerdhen.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Shpz në ,000 lekë

Produktet	Njesia matese	Plani	Fakt	Shpz Plani	Shpz Fakt
Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social	numër	11	11	9,013	5,951
Fëmijë që frekuentojnë çerdhet	numër	50	41	900	32

Realizimi i fondit prej 660 mije leke është parashikuar në programin e Arsimit baze ardhur si buxhetim i vitit të kaluar në këtë program.

Të dhënat e Programit:

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Ofrimi i sigurisë dhe garantimi i kushteve optimale për rritjen e fëmijëve 0-3 vjeç në çerdhe

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Kujdesi në çerdhe është sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i fëmijëve për çdo edukatore në çerdhe	9	9
Numri i çerdheve	Numri i çerdheve	1	1
Shërbime ushqimore për rritjen e fëmijëve në kopsht & çerdhe	numër	12	4
Edukatore në çerdhe	numër	5	5
Fëmijë të regjistruar në çerdhe	numër	50	41
Kapaciteti maksimal i akomodimit (numri i shtretërve në fjetore)	numër	110	94

III.11 Programi Furnizimi me Ujë Bashkia.

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit
06370

Emri i Programit
Furnizimi me uje

Përshkrimi i Programit

Ky program perfshin nderhyrjet ne ndertimin e linjave te reja te kanalizimeve të ujrave të bardha dhe atyre të zeza ne territorin e Bashkise Patos si dhe rikonstrukcionin e linjave ekzistuese aty ku eshte e mundur. Gjithashtu programi perfshin edhe nderhyrjet në shtrimin e linjave te reja të furnizimit me ujë të banoreve si edhe rehabilitimin e rrjetit të furnizimit me ujë.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për vitin aktual buxhetor (buxheti i pritshëm dhe buxheti faktik) dhe realizimin për 4-mujorin e II-rë të vitit 2025.

• **Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik:**

Në 000 lekë

Përshkrimi	Llogaria ekonomike	I pritshmi	Fakt	Realizimi Fakt
Pagat	600	0	0	0
Sigurimet Shoqërore	601	0	0	0
Mallra dhe shërbime	602	0	0	0
Të tjera transferta korrente të brendshme	604	0	0	0
Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	606	0	0	0
Kapitale të Trupëzuara	231	4,457	4,363	98 %

Totali

Plan i rishikuar	Fakt	Realizimi
4,457	4,363	98%

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi 1. Sigurimi dhe përmirësimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve .

Objektivi 1.1 Funksionimi, përmirësimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe te bardha.

- Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza;

Indikatori	Njesia matese	Plan	Fakt
Permiresim Rrjeti KUZ dhe KUB me fondet e bashkise	ML	1436	350

Projektet e Investimeve të Programit

Kodi i projektit	Emri i projektit	Vlera e plote e projektit	Fillon	Mbaron	Plan i rishikuar	Fakt
1120070	Ndertim KUZ dhe KUB(baza materiale(	4,457	2025	2025	4,457	4,363

III.12 Programi Arsimi Bazë e Parashkollor, Njesitë shpenzuese:Bashkia, ASHP.

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve. Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore;

